



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 89-Nentor 2010 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



Pamje nga Qendra e Kompetences ne Malishevë



Përmbajtja:

GLV “Llapusha”, realizoi projektin e parë.....	3
Nesër bëhet përrurimi i Qendrës së Kompetencës	4
Përrurohet Qendra e Kompetencës në Malishevë	5
Nga takimi i KKSB-se	7
Roli dhe funksioni i KPMSHC- se - Të drejtat dhe përgjegjësitë e shërbyeseve civile	7
Kryetari Kilaj priti komandantin e BSHJ-së, Gjeneral Stephan Thomas.....	8
Disa nga shkollat e Malishevës përfitojnë nga Banka Botërore.....	9
Përrurohet edhe një shkollë në Malishevë	10
Mbahet Darka tradicionale me veteranët e UÇK-së.....	11
Miratohet Lista e projekteve për vitin e ardhshëm.....	12

GLV “Llapsha”, realizoi projektin e parë

Malishevë, 3 nëntor



Grupi Lokal i Veprimit (GLV) “Llapusha”, ka realizuar projektin e parë të saj, duke rregulluar një park me hapësirë të gjelbërt: kubëza, ulëse, dhe drunj dekorativ në oborrin e Gjimnazit “Abdyl Frashëri” në Malishevë. Projekti është financuar nga Komuna e Malishevës dhe Ministria e Bujqësisë.

Koordinatori i projektit, Isa Ulluri, tha: ky projekt i ka kushtuar tetë mijë euro,

ndërsa është financuar nga Komuna e Malishevës dhe Ministria e Bujqësisë, ndërsa parku ka një hapësirë prej 460 metra katrorë, dhe do të jetë në shërbim kryesisht të nxënësve, por edhe të prindërve të tyre dhe qytetarëve tjerë.

Krahas investimeve tjera të komunës, edhe ky rast është një investim në infrastrukturën edukative, tha Enver Mazreku nga GLV Llapusha, duke e falënderuar komunën dhe Kryetarin Isni Kilaj, për mbështetjen e këtij projekti, si dhe për mbështetjen që i ka dhënë Grupit Lokal të Veprimit.

Ky është projekti i parë i realizuar nga GLV, por ne kemi edhe strategjinë e zhvillimit lokal dhe kjo strategji është e mbështetur edhe nga Kryetari i komunës, z. Isni Kilaj, deklaroi Mazreku. Sipas tij GLV, ka edhe projekte tjera, ndërsa prioriti i tyre është, promovimi i vlerave turistike të Malishevës, ku përfshihen: Ujëvarat e Mirushës, Pishinat e Banjës, Shpellat e Panorcit dhe i Ngucatit, të cilat përmes projekteve do të prezantohen para opinionit. Një prioritet tjetër i GLV-së është edhe zhvillimi i ekonomisë rurale, saktësisht, blegtorisë dhe bujqësisë, pasi komuna jonë i ka këto resurse dhe ka mundësi të zhvillimit të saj, tha Enver Mazreku.

Vlen të theksohet se GLV-ja, është formuar, më 10 mars 2009, ndërsa përbëhet nga përfaqësues të sektorit publik dhe privat.

Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Nesër bëhet përrurimi i Qendrës së Kompetencës

Malishevë, 8 nëntor

Në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, të udhëhequr nga Kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, është diskutuar rreth përgatitjeve për përrurimin zyrtar të shkollës së mesme profesionale Qendra e Kompetencës dhe fillimin e procesit mësimor në të.

Përrurimi i kësaj Qendre të Kompetencës do të bëhet nesër, me ç'rast pritet të marrin pjesë, përveç personaliateve komunale, edhe nga shteti i Norvegjisë dhe niveli shtetëror vendor, të cilët edhe në kontribuar në ndërtimin e kësaj Qendreje.



Nesër është hapja zyrtare e Qendrës së Kompetencës dhe dëshiroj që çdo gjë të shkojë si është më së miri sa i përket ceremonisë së hapjes, njëkohësisht të ketë edhe një fillim të mbarë të procesit mësimor, kështu ka kërkuar në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, Kryetari Isni Kilaj, ndërsa drejtori i Qendrës së Kompetencës, Besim Dobruna dhe Drejtori i Arsimit Isuf Morina, kanë njoftuar për përgatitjet që janë bërë për të martën, më 9 nëntor.

Në mbledhjen e sotme është diskutuar edhe për disa nga projektet në vazhdim, pastaj vendosjen e tabelave shënuese në rrugën e asfaltuar, “Habib Berisha”, dhe për Qendrën e Kompetencës.

Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, kërkoi nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, që të shikohen mundësitë për ta ndihmuar me gjëra elementare një familje në fshatin Ngucat pasi shtëpia e saj ditëve të fundit është djegur në tërësi.

Përurohet Qendra e Kompetencës në Malishevë

Malishevë, 9 nëntor



Kryetari i Komunës së Malishevës, Isni Kilaj, përurimin e shkollës e njohur si Qendra e Kompetencës, e cilësoi dritare për këtë komunë; Ministri i MTPT-së, Fatmir Limaj, e falënderoi popullin norvegjez për ndërtimin e shkollës, ndërsa për ambasadorin Kvale, tha se është ambasador që viziton dhe njihet me nevojat e qytetarëve të Kosovës.

Sot edhe zyrtarisht është përruar shkolla e mesme profesionale Qendra e Kompetencës në Malishevë, ndërsa prerjen e shiritit e kane bërë, ambasadori norvegjez në Kosovës, z.Sverre Johan Kvale, Kryetari i komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, Ministri i MASHT-it, z.Enver Hoxhaj, Ministri i MTPT, z.Fatmir Limaj dhe drejtoresha e sektorit për ndihmë Ballkanit Perëndimor (MFA), znj.Margit Tveiten.

Kjo Qendër shkollore, ka një hapësirë prej afro 10 mijë metra katrorë, ndërsa është ndërtuar nga Qeveria e Norvegjisë dhe MASHTK, e cila ka kushtuar rreth pesë milionë euro, ndërsa ka disa drejtime profesionale, si në ekonomi, administratë dhe informatikë.



Urime! Tha fillimisht në gjuhën shqipe ambasadori norvegjez, Sverre Johan Kvale, duke marrë fjalën me këtë rast. Të ndërtohen shkolla në një shtet të ri, me popullatë të re është gjë e mirë dhe këtë e kam thënë edhe kur e kemi vendosur gurëthemelin e kësaj shkolle. Kjo shkollë është e veçantë, dhe ka pak të tilla në tërë regjionin me standarde evropiane, ndërsa nxënësit që dalin nga këtu mund të gjejnë punë në gjithë evropën. Ai më pas duke falënderuar ata që kanë kontribuar në ndërtimin e shkollës, në veçanti Kryetarin e Komunes së Malishevës, z. Isni Kilaj, që për të është Kryetari i favorizuar i një komune që ai e preferon më së shumti, dhe në veçanti për përmbushjen me kohë të të gjitha premtive, ndaj z Kilaj nuk është vetëm kryetar, por edhe mik i mirë, tha Kvale, i cili i falënderoi edhe ministriat Limaj dhe Hoxhaj, për vizionin e tyre për edukimin dhe për nevojat e kësaj ane.

Jam i emocionuar dhe mund të them më i lumturi në botë, pasi po përurojmë një shkollë me përmasa evropiane dhe të standardeve të kohës tha Kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj. Ashtu siç është Mikrosoft për botën e teknologjisë, edhe kjo shkollë e jona është një dritare për Malishevën, nga e cila do të marrin dritë dhe dije gjeneratat e ardhshme, dhe unë në emër të popullit të Malishevës, i falënderoj të gjithë ata që kontribuan në ndërtimin e kësaj shkolle, popullin norvegjez, Ministrinë e Arsimit, Qeverinë e Kosovës në përgjithësi, e në veçanti falënderoj ambasadorin Sverre Johan Kvale, pasi me një punë titanike, ka bërë që të ngritet kjo shkollë. Ndërkohë që një falënderim tjetër adresoi edhe për ata që kanë kontribuar dhe punuar, që ne sot të krenohemi me këtë shkollë, tha Kryetari Kilaj.

Më pas Ministri i Arsimit z. Enver Hoxhaj, e cilësoi si një ditë të veçantë, jo vetëm për Malishevën, por edhe për Kosovën përmirësimin e shkollës më moderne në Ballkan, ndërsa Qendrën e Kompetencës, e vlerësoi si *“forca motorike e zhvillimit të Malishevës”* Ambasadori Kvale, më inspiron në punën time si ministër, ambasadori Kvale nuk është vetëm ambasador i Norvegjisë, por është edhe ambasador i arsimit në Kosovë, tha Hoxhaj, duke e falënderuar atë, përderisa edhe ka treguar tërë rrugën e ndërtimit të shkollave në Malishevë dhe Skënderaj.

Edhe Ministri i MTPT-së, z. Fatmir Limaj, duke i uruar të gjithë për ndërtimin e kësaj shkolle, ka falënderuar ambasadorin norvegjez, duke e cilësuar si një nga ambasadorët që nuk rrinë vetëm në Prishtinë, por e viziton tërë Kosovën, i është drejtuar drejtoreshës për ndihmë Ballkanit Perëndimor znj. Margit Tveiten me këto fjalë: “Drejtoreshë, përmes juve e përcjellim mesazhin e ngrohtë për popullin norvegjez, se ne iu jemi mirënjohës përjetësisht për këtë mrekulli që keni bërë”. Ndërsa ambasadorin Kvale, Ministri Limaj e ka vlerësuar si qytetarin më të dashur për të gjithë banorët e Komunës së Malishevës.



Nga takimi i KKSB-se

Malisheve, 11 nëntor

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), ka mbajtur sot takimin e saj të radhës, ku është vlerësuar situata e sigurisë së përgjithshme në komunën e Malishevës. Sipas anëtarëve të KKSB-së, siguria e përgjithshme në Malishevë është e qetë dhe stabile.

Veprat penale kanë shënuar rënie në krahasim me muajin e kaluar, përderisa shqetësim për policinë vazhdon të jetë siguria në trafik, kanë raportuar zyrtarët nga Stacioni Policor në Malishevë. Po ashtu sipas policisë, do të ketë shtim të aktiviteteve policore gjatë fushatës parazgjedhore dhe në ditën e zgjedhjeve, në mënyrë që të sigurohet ambient i qetë gjatë kësaj kohe.

Edhe shoqëria civile e ka vlerësuar të qetë situatën e sigurisë së përgjithshme, përderisa përfaqësuesi i Bashkësisë Islame, mulla Xhevat Kryeziu, ka njoftuar për disa raste të pajtimeve në kuadër të aktiviteteve të Këshillit të Pajtimit të Gjaqeve.

Në organizimin e KPMSHCK-së , OSBE dhe QPA-së u mbajt seminari me temën:

Roli dhe funksioni i KPMSHC-së - të drejtat dhe përgjegjësitë e shërbyesve civilë

Malishevë, 11 nëntor

Në organizimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës KPMSHCK, OSBE dhe Qendrës për Avokim, është mbajtur seminari njëditor me temën: *Roli dhe funksioni i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - të drejtat dhe përgjegjësitë e shërbyesve civilë*

Të pranishëm në këtë seminar ishin zyrtarë institucional dhe të shoqërisë civile nga Komuna e Malishevës dhe ajo e Therandës.

Për rolin dhe funksionet e KPMSHCK-së, ka folur z. Bajram Zogjani, anëtar i këtij Këshilli, ndërsa për të drejtat dhe përgjegjësitë e shërbyesëve civilë konkretisht për ligjin mbi Shërbimin Civil, ka folur z. Naim Abazi.

Sipas z. Zogjani, baza ligjore për funksionimin e KPMSHCK-së, janë Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, Ligji për Shërbimin Civil dhe Ligji mbi Procedurat Administrative (Ligji Nr.02L-28). Ky Këshill ka tre funksione shumë të rëndësishme, si: shqyrtimi i ankesave, mbikëqyrja dhe vëzhgimi, ka interpretuar më tej z. Zogjani punën e këtij Këshilli duke u nda e më pastaj edhe te kompetencat, vendimet, afatet e ekzekutimit, bashkëpunimin, financimin, si dhe raportimin që në këtë rast ky Këshill i jep Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ndërsa sa i përket temës në lidhje me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, z. Naim Abazi, ka folur në lidhje me dispozitat e përgjithshme të këtij ligji, pastaj për fusheveprimtarinë e tij, për parimet themelore të Shërbimit Civil, pranimin, emërimin dhe kushtet e punësimit në Shërbimin Civil, etj.

Kryetari Kilaj priti komandantin e BSHJ-së, Gjeneral Stephan Thomas

Malishevë, 18 nëntor

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur sot Komandantin e Brigadës Shumëkombëshe të Jugut (BSHJ), gjeneralin Stephan Thomas, me të cilin ka biseduar për rrjedhat e përgjithshme në Malishevë dhe situatën e sigurisë, me ç'rast janë vlerësuar, situata e sigurisë në vend dhe puna e Policisë së Kosovës.

Fillimisht, kryetari Kilaj duke i dëshiruar mirëseardhje komandantit





të BSHJ-së, e njoftoi atë me gjendjen e përgjithshme në komunën e Malishevës, investimet dhe nevojat që ka Malisheva. Malisheva konsiderohet rajoni më i pazhvilluar në Kosovë, duke pasqyruar se që nga vitet e '70-ta nuk është investuar asgjë në këtë pjesë, tha ai, i cili pastaj njoftoi komandantin me investimet e bëra gjatë këtij viti, duke i veçuar disa nga projektet e realizuara si: ndërtimi i shkollës së mesme profesionale, një investim kapital i Qeverisë së Norvegjisë dhe MASHTK-së, dy shkolla të tjera fillore, Mleqan e Senik, rrugë, trotuare, ujësjellës, kanalizime, shtrati i përroskës në qytet parqet si dhe projektet tjera në përfundim e sipër, si: Shtëpia e Kulturës, Palestra e Sportit, shkolla në Banjë, etj.

Ndërsa gjenerali Stephan Thomas, tregoi se është i kënaqur me të arriturat gjatë viteve të fundit. Sipas tij rregullimi i infrastrukturës, pastaj fillimi i ndërtimit të autostradës, tregon çfarë përparimi ka bërë Kosova viteve të fundit, për të cilën duhet të jeni krenar. Sa i përket situatës së sigurisë, gjenerali tha : “Situata e sigurisë në Kosovë ka marrë drejtimin e duhur dhe është në rrugë të drejt, kurse Policia e Kosovës, ka marrë përgjegjësi në shumë sfera dhe po punon shumë, prandaj shoqëria kosovare duhet të jetë krenare me punën e saj”.

Vlen të theksohet edhe ajo që sipas komandantit të BSHJ-s Stephan Thomas, “gjendja e sigurisë në Kosovë, në të gjitha masat është treguar pozitive, ndërsa reduktimi i forcave të KFOR-it dhe dorëzimi i kompetencave tek organet vendore është shumë e rëndësishme”.

Disa nga shkollat e Malishevës përfitojnë nga Banka Botërore

Malishevë, 23 nëntor

Në kuadër të programit të Bankës Botërore për zhvillimin e arsimit, disa nga shkollat e Malishevës, kanë përfutur mbi 84 mijë euro, përmes të cilave do të realizohen projekte në infrastrukturën e shkollave dhe nevojave të tyre.

Sipas Drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit, z. Isuf Morina mjetet do të përdoren për projekte të ndryshme në infrastrukturë, pastaj në pajisjen e shkollave me mjete të tjera që kanë të bëjnë me lëndët mësimore, bibliotekë e të tjera, përkatësisht në përmirësimin e cilësisë së arsimit, në mënyrë që shkollat të bëhen sa më bashkëkohore për nxënësit .

Në këtë kontekst drejtori Morina ka bërë të ditur se shkollat në të cilat do të investohet nga Banka Botërore, janë: SHMPEJ “Lasgush Poradeci” në Kijevë, me një shumë prej 11.404 euro, rregullimi i oborrit, kënde të gjelbëruara, pastaj në shkollën fillore “Vesël Pagarusha” në Pagarushë me 6.285 euro të përfituara është paraparë pajisja e bibliotekës me libra të ndryshëm, në shkollën “Visar Krasniqi” në Drenoc një projekt i vogël i përfituar do të përdoret për pajisjen e një paralele të parashkollorëve, në shkollën fillore “Bajram Curri” të këtij fshati 6.450 euro të përfituara, do të shpenzohen në rregullimin e një kabineti të informatikës, etj.

Sipas Drejtorit të Arsimit në Malishevë, Isuf Morina, nevojat e investimeve në shkollat e Malishevës, janë edhe më tej të mëdha, pasi krahas nevojës për ngritjen e disa shkollave, ka nevojë të investohet edhe në përmirësimin e ambienteve, si dhe pajisjen e shkollave me kabinete dhe mjete tjera përcjellëse.

Përurohet edhe një shkollë në Malishevë

Malishevë, 26 nëntor

Në fshatin Mleqan të komunës së Malishevës, sot është përuar ndërtesa e re e shkollës „Beqir Gashi”, e ndërtuar nga MASHT-i. Prerjen e shiritit e bëri Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, Drejtori i Arsimit në Malishevë, z. Isuf Morina dhe z. Osman Gashi, vëllai i dëshmorit, emrin e të cilit e



mban shkolla.

Jam i lumtur sepse nxënësit e kësaj shkolle kurrë më nuk do të ndjekin mësimet në kontejner dhe në kushte të rënda, kurse mësimdhënësit nuk do ta kenë më brengën për nxënësit, dhe do kenë mundësi shumë më të mëdha që të ofrojnë mësim cilësor, tha Kryetari i komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, me rastin e përrurimit të kësaj shkolle.

“Ne gjatë këtij viti kemi përruruar edhe shkolla tjera si atë në Malishevë, në Senik e në Tërpezë, kurse në komunën tonë po ngritën edhe shkolla tjera moderne, të cilat do të krijojnë kushte shumë më të mira për mësim për të gjithë fëmijët të cilët janë e ardhmja jonë”, tha kryetari Kilaj.

Meritat për këto ndërtime, Kilaj, iu dedikoi dëshmorëve dhe lirisë që e gëzojmë, falë gjakut të tyre. Ai më pas tha se “për ngritjen e këtij objekti të bukur shkollor, ne gjithsesi i jemi mirënjohës ndihmës së pakursyeshme të Qeverisë së Republikës së Kosovës të drejtuar nga Kryeministri Hashim Thaçi”.

Ndërsa, drejtori i SHMU “Beqir Gashi”, z. Alush Kryeziu, tha se kjo shkollë është e vjetër 46 vjet, duke filluar mësimi nëpër shtëpi, më 1946, ndërsa në luftën e fundit, ishte edhe shtai i UÇK-së, për çka edhe u dogj e tëra. “Deri më tani, nga paslufta, kemi mësuar në një aneks të riparuar dhe në dy kontejner, kurse sot me pëlqimin e kryetarit Kilaj dhe me investimin e MASHT-it, ne kemi këtë shkollë moderne”, tha Kryeziu.

Kjo shkollë buxhetit të MASHT-it, i ka kushtuar 430 mijë euro, ka dhjetë dhoma mësimi, një kabinet të informatikës, dy fusha sportive dhe zyra tjera për nevoja të shkollës.

Përndryshe, SHMU “Beqir Gashi”, është shkolla e parë në Kosovë që kishte ueb faqen e saj edhe pse mësonin në kontejner.

Mbahet darka tradicionale me veteranët e UÇK-së

Malishevë, 28 nëntor

s

Në përkujdesjen e Kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, është organizuar *Darka tradicionale* me veteranët e luftës së UÇK-së, nga komuna e Malishevës, ku kanë marrë pjesë edhe presidenti në detyrë, z. Jakup Krasniqi, Ministri i MTPT-së, Fatmir Limaj dhe ish Ministri i





mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, z.Sabit Brokaj.

Fillimisht Kryetari i Malishevës, Isni Kilaj, falënderoj të pranishmit, dhe tha: kjo është Darkë tradicionale, por ka rastisur me fushatën paraelektorale, duke u ndërlidhur më pastaj me festat e Nëntorit, sipas të cilit nëntori është muaji ku lidhen shumë ngjarje të rëndësishme historike të popullit shqiptar, duke filluar nga Skënderbeu, për të vazhduar me Ismail Qemalin e për të përfunduar, me datëlindjen e Komandantit Legjendar Adem Jasharit dhe daljes publike të UÇK-së!

Nëntori na sjell frymën e atdhedashurisë, lirisë, dhe të pavarësisë; nëntorët i kanë dhuruar dinjitet dhe krenari kombit shqiptar, tha presidenti në detyrë Jakup Krasniqi.

Ndërsa për ish Ministrin Sabit Brokaj, 28 Nëntori, është festë e gjithë shqiptarëve dhe kësaj feste iu shtua edhe datëlindja e Adem Jasharit dhe dalja e parë në publik e UÇK-së. Vlerat e luftës duhet t'i ruani me xhelozë, tha Brokaj, para veteranëve të UÇK-së në Malishevë, duke bërë thirrje për ruajtje të unitetit.

Me këtë rast veteranët e UÇK-së, i ka përshëndetur edhe Ministri i MTPTK-së, Fatmir Limaj, ish komandant „Çeliku”. Më 2012 në kuadër të 100- vjetorit të festave të Nënë do ta përurojmë rrugën e kombit dhe në 100- vjetorin e pavarësisë, Prishtina me Vlorën do të jenë vetëm tri orë larg!

Miratohet Lista e projekteve për vitin e ardhshëm

Malishevë, 30 nëntor



Në mbledhjen e dhjetë të radhës së Asamblesë Komunale të Malishevës, të udhëhequr nga Kryesuesi, z.Ragip Begaj, është miratuar Lista e projekteve prioritare për vitin 2011, e propozuar nga Kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, ndërkohë që Listës iu janë bashkangjitur edhe një varg propozimesh tjera nga këshilltarët e kuvendit.

Në prezantimin e Listës prej 14 projekteve, të cilat do të mund të realizohen, jashtë buxhetit komunal, ndërkaq Kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, tha : përmes fondeve të ndryshme qeveritare apo joqeveritare, besoj se do të realizohen shumica prej tyre!



Në pjesën e dytë të seancës së radhës, me kërkesën e këshilltarëve komunal, Drejtori i Arsimit, z.Isuf Morina, ka raportuar për përfundimin e vitit shkollor 2009-2010 dhe fillimin e vitit shkollor 2010-2011, ndërsa është përgjigjur edhe në pyetjet e këshilltarëve, për çështje të caktuara në fushën e ecures së procesit mësimor, kushteve të objekteve shkollore dhe për stafin mësimdhënës.

Mbledhja e sotme e Kuvendit për rend dite kishte paraparë gjithsej pesë pika, përfshirë këtu procesverbalin nga mbledhja e kaluar dhe atë të ndryshme.